

OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË

**Rezultatet e një sondazhi të opinionit publik
të kryer në Shqipëri**

Shtator, 2017



OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË

Rezultatet e një sondazhi të opinionit publik të kryer në Shqipëri

BOTUES

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 1, Tirana, Albania

Tel: +355 4 240 0241

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org

www.pointpulse.net

AUTOR

Redion Qirjazi

REDAKTOR

Saša Djordjević

PËRKTHYER NË SHQIP NGA

Durim Tabaku

GRAFIKA DHE FAQOSJA

DTP

Tiranë, 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE.....	4
PËR SONDAZHIN	5
PËRMBLEDHJE	6
BESIMI NË INSTITUCIONE.....	7
Institucionet më të besuara janë policia dhe media	7
PERCEPTIMI PËR POLICINË.....	10
Shumica e njerëzve në Shqipëri kanë perceptim të mirë për policinë	10
Punësimi në polici perceptohet nëpërmjet konkursit publik.....	13
Shumica e qytetarëve thonë se policia punon në interes të qytetarëve	13
Politika ndikon në punën operative të policisë	14
PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN	15
Gjykatat mbeten institucioni më i korruptuar	15
Perceptimi i korrupsionit në polici ka pësuar rënie	17
Bashkëpunëtorët më të afërt të Ministrisë së Brendshme janë pjesa më e korruptuar e policisë	18
LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	20
Më shumë qytetarë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin e policisë nëse të dhënat e denoncuesit do të ishin konfidenciale	20
Rajonet e policisë dhe media mbeten zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit në polici... ..	21
Ndëshkimi si mënyra më efektive për parandalimin e korrupsionit në polici	23
Qeveria duhet të udhëheqë luftën kundër korrupsionit	24
Shoqëria civile duhet të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit	25
KUADRI METODOLOGJIK	26

LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

Grafiku 1: Besimi dhe mosbesimi në përgjithësi tek institucionet

Grafiku 2: Besimi në përgjithësi tek policia në Shqipëri

Grafiku 3: Mendimi i parë për policen femër (shumë përgjigje)

Grafiku 4: Mendimi i parë për policen femër (përgjigjet e para)

Grafiku 5: Mendimi i parë për policin tipik (shumë përgjigje)

Grafiku 6: Mendimi i parë për policin tipik (përgjigjet e para)

Grafiku 7: Format e punësimit në polici

Grafiku 8: Si vepron policia?

Grafiku 9: Ndikimi i politikës në punën e policisë

Grafiku 10: Përhapja e korrupsionit në institucionet shqiptare

Grafiku 11: Perceptimi për korrupsionin në polici në 2016 dhe 2017

Grafiku 12: Perceptimi për korrupsionin në polici sipas gjinisë, moshës dhe prejardhjes gjeografike

Grafiku 13: Perceptimi i përgjithshëm për korrupsionin në polici

Grafiku 14: Perceptimi për korrupsionin në njësi të caktuara të policisë

Grafiku 15: Denoncimi i korrupsionit të policisë në Shqipëri

Grafiku 16: Moshë, gjinia, prejardhja në denoncimin e korrupsionit në radhët e policisë

Grafiku 17: Zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit në radhët e policisë (shumë përgjigje)

Grafiku 18: Zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit në radhët e policisë (përgjigjet e para)

Grafiku 19: Çfarë nevojitet për parandalimin e korrupsionit në polici

Grafiku 20: Roli i institucioneve në luftën kundër korrupsionit në polici

Grafiku 21: Roli i shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit

Tabela 1: Besimi tek institucionet në Shqipëri

Tabela 2: Korrupsioni në institucionet shqiptare

Tabela 3: Korrupsioni në njësitë e policisë në Shqipëri

PËR SONDAZHIN

Raundi i tretë i sondazhit të opinionit publik “Opinionit i qytetarëve për forcat e policisë” u zhvillua në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi. Pyetësi në bazë të të cilit u krye sondazhi i opinionit publik u hartua nga rrjeti rajonal POINTPULSE për t’iu dhënë përgjigje në lidhje me mendimin e qytetarëve për policinë. Pyetësi kishte gjashtë grupe pyetjesh:

1. Niveli i besimit të qytetarëve tek institucionet;
2. Perceptimi për policinë si institucion, por edhe për oficerët dhe oficeret e policisë si individë;
3. Perceptimi për korrupsionin në shoqëri dhe në forcat e policisë;
4. Opinioni i qytetarëve për luftën kundër korrupsionit;
5. Opinioni i qytetarëve për punën e organizatave të shoqërisë civile;
6. Të dhëna demografike.

Kërkimi në terren në Shqipëri u krye në korrik të vitit 2017 nga IPSOS Strategic Marketing, me një kampion përfaqësimi prej 1,000 personash madhorë, qytetarë të Shqipërisë. Si instrument kërkimi u përdor një pyetësor dhe intervistat u kryen duke përdorur teknikën “ballë për ballë”, teknikë që mundëson kontakt të drejtpërdrejtë me të intervistuarit.

Raporti u botua si pjesë e projektit “Pulsi i Ballkanit Perëndimor për Integritetin dhe Besimin në Polici”, projekt që synon të kontribuojë në rritjen e besimit tek policia duke promovuar përgjegjshmërinë dhe duke forcuar integritetin e saj. Për këtë arsye, shtatë organizatat e shoqërisë civile nga rajoni u bënë bashkë për të krijuar rrjetin POINTPULSE: Analytica nga Shkupi, Qendra e Beogradit për Politikë e Sigurisë (BCSP) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) nga Beogradi, Qendra për Studime të Sigurisë (CSS) nga Sarajeva, Instituti Alternativa (IA) nga Podgorica, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Tirana, dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nga Prishtina.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Instrumenti i Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

PËRMBLEDHJE

Policia është institucioni më i besuar në Shqipëri. Pothuajse dy të tretat (61%) e publikut thonë se i besojnë policisë. Megjithatë, shumica e institucioneve shqiptare, të përzgjedhura për këtë sondazh të opinionit publik, nuk kanë besimin e publikut. Mesatarisht, në vitin 2017, 46% e shqiptarëve u besojnë institucioneve krahasuar me 44% në vitin 2016. Rezultatet mbi perceptimet për policinë ndryshojnë sipas moshës, gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike. Femrat tregojnë një besim më të madh tek policia (63%) në krahasim me meshkujt (59%). Të intervistuarit në qytete i besojnë policisë më pak se ata të zonave rurale. Njerëzit mbi 45 vjeç kanë besim më të madh në polici dhe të anketuarit me nivel më të ulët arsimor kanë më shumë besim te policia.

Policet femra perceptohen si të sjellshme dhe me kulturë (25%) e ndjekur nga përkrahja “kryen detyrën siç duhet” (17%) dhe miqësore dhe e dobishme (16%), ndërsa zyrtarët meshkuj konsiderohen si të aftë dhe efikas (17%), të fortë dhe të fuqishëm (13%) dhe seriozë e të përgjegjshëm (9%). Sondazhi i vitit 2017 tregoi se 66% e qytetarëve besojnë se rekrutimi në radhët policisë bëhet përmes konkursit publik në krahasim me 56% që mendonin kështu në vitin 2016. Ky trend pozitiv tregon një rritje të besimit tek procesi i drejtë dhe profesionalizmin me të cilin punësohen punonjësit e policisë. Për më tepër, në vitin 2017, 66% besojnë se policia është në shërbim të qytetarëve shqiptarë, krahasuar me 55% në 2016. Megjithatë, shumica (69%) besojnë që politikanët ndikojnë në punën operationale të policisë, ndonëse kjo shifër është edhe më e ulët se ajo e vitit 2016 (79%).

Pak më shumë se gjysma e popullsisë (52%) besojnë se korrupsioni në forcat e policisë është shumë i përhapur në krahasim me 62% të vitit të kaluar. Mesatarisht, perceptimi i korrupsionit në polici mbetet në nivele të ngjashme sipas ndarjes gjinore, grupmoshave dhe prejardhjes gjeografike. Edhe perceptimi për korrupsionin një njësi të caktuar të policisë është ulur që nga viti 2016 nga 51% në 45%. Njësitë më të korruptuara të policisë janë bashkëpunëtorët më të afërt të ministrit me 52%, të ndjekur nga policia kufitare me 49%. Policia rrugore ka arritur rezultatet më pozitive në reduktimin e perceptimit të korrupsionit, nga 63% që e konsideronin atë si njësinë më të korruptuar në vitin 2016, në 43% në vitin 2017.

Qytetarët kanë më shumë gjasa të denoncojnë një rast korrupsioni të policisë në vitin 2017 (54%) krahasuar me 2016 (47%). Kjo shifër do të ishte edhe më e lartë, nëse identiteti i qytetarëve denoncues do të mbahej i fshehtë. Të intervistuarit meshkuj të moshës 18-29 vjeç janë më shumë të predispozuar të denoncojnë rastet e korrupsionit të policisë. Ashtu si në vitin 2016, zgjedhja e parë për raportimin e korrupsionit të policisë është pikërisht rajoni i policisë, pasuar nga mediat.

Shumica e shqiptarëve gjithnjë e më shumë besojnë se dënimet e ashpra për autorët dhe drejtuesit e policisë janë çelësi për parandalimin e korrupsionit në polici. Për më tepër, 31% besojnë se qeveria duhet të udhëheqë luftën kundër korrupsionit në polici, pasuar nga Ministri i Brendshëm me 16%. Këto të dhëna përafrojnë shumë me ato të një viti më parë. Kur krahasojmë rezultatet e vitit 2016, këtë vit shqiptarët po i vënë më shumë theks rolit më të madh “këshillues” dhe rritjes së kapaciteteve të organizatave joqeveritare sesa pjesëmarrjes aktive në luftën kundër korrupsionit të OJQ-ve.

BESIMI NË INSTITUCIONE

Institucionet më të besuara janë policia dhe media

Besimi tek institucionet publike është i rëndësishëm për suksesin e një sërë politikash publike. Kjo ndihmon në rritjen e besimit të investitorëve dhe konsumatorëve dhe përmirëson shanset e suksesit të shumë politikave dhe programeve të qeverisë. Ashtu si në vitin 2016, u bë një matje e besimit të publikut për dymbëdhjetë institucione shqiptare: doganat, arsimit, shëndetësia, gjykatat, inspektorati i tregut, policia, bashkitë, Kuvendi, media, organizatat joqeveritare (OJQ), Agjencia kundër Korrupsionit, dhe Prokuroria. U zgjodhën këto institucione, sepse ato luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Pjesës më të madhe të institucioneve të përzgjedhura në Shqipëri u mungon besimi i publikut. Në fakt, të vetmet institucione që shqiptarët janë më të prirur t'u besojnë janë policia (61%), sistemi arsimor (55%), mediat (60%), OJQ-të (52%) dhe bashkitë (51%). Ajo që bie në sy janë institucionet që kanë fituar më shumë besimin e publikut: policia dhe mediat. Ky fakt përbën ndryshimin pozitiv për policinë, e cila ka përmirësuar vlerësimin e saj me 5%. Institucionet me nivelin më të ulët të besimit publik janë gjykatat (33%), Parlamenti (33%), Prokuroria (35%) dhe doganat (36%).

TABELA 1: BESIMI TEK INSTITUCIONET NË SHQIPËRI

Pyetje: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim tek institucioni, 2 kryesisht nuk kam besim tek institucioni, 3 deri diku kam besim tek institucioni, 4 kam plotësisht besim tek institucioni (një përgjigje; baza: e gjithë popullata e synuar)


	VITI	NUK I BESOJ ASPAK	KRYESISHT NUK I BESOJ	KRYESISHT I BESOJ	I BESOJ PLOTËSISHT	NUK E DI	SHUMA – (1+2)	SHUMA + (3+4)
DOGANAT	2017	27	33	33	3	4	60	36
	2016	34	28	29	5	5	61	34
ARSIMI	2017	17	26	43	12	2	43	55
	2016	22	17	44	17	2	38	60
SHËNDETËSIA	2017	22	32	36	9	1	54	45
	2016	33	22	36	9	0	55	45
GJYKATAT	2017	34	32	28	5	1	66	33
	2016	46	21	26	7	1	67	33
INSPEKTORËT E TREGUT	2017	27	33	32	4	4	60	36
	2016	37	26	29	6	3	63	35

POLICIA	2017	16	23	47	14	0	39	61
	2016	23	20	40	16	1	43	56
BASHKIA	2017	20	28	41	10	1	48	51
	2016	25	23	37	12	3	48	49
KUVENDI	2017	33	32	28	5	2	65	33
	2016	55	19	20	5	1	74	25
MEDIA	2017	15	23	48	12	2	38	60
	2016	21	18	44	18	0	38	62
OJQ-TË	2017	20	23	38	14	5	43	52
	2016	30	18	35	13	5	47	48
AGJENCIA ANTI-KORRUPSION	2017	25	29	35	7	4	54	42
	2016	35	25	27	8	6	59	35
PROKURORIA	2017	30	33	30	5	2	63	35
		43	21	26	9	2	64	34

Pothuajse të gjitha institucionet kanë pasur një rritje të besimit të publikut në krahasim me vitin e kaluar me përjashtim të sistemit arsimor, i cili ka shënuar një rënie të lehtë në 55% krahasuar me 60% të vitit të kaluar dhe mediat me një vlerësim të besueshmërisë së tyre prej 60% krahasuar me 62% në 2016. Megjithatë, të dyja këto institucione (si dhe policia) mbeten ndër tre më të besuarat e publikut. Në të njëjtën kohë kanë rënë edhe nivelet e mosbesimit tek institucionet. Edhe pse, siç u tha më parë, ka pasur një rritje të besimit të publikut tek institucionet shtetërore, si një e tërë, shqiptarët nuk besojnë ende tek institucionet e tyre. Mesatarisht, në vitin 2016, 44% e shqiptarëve u besonin institucioneve të tyre, ndërsa në vitin 2017, kjo shifër u rrit në 46%; ndryshim i cili statistikisht është i pakonsiderueshëm.

GRAFIKU 1: BESIMI DHE MOSBESIMI NË PËRGJITHËSI TEK INSTITUCIONET

Pyetje: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim tek institucioni, 2 kryesisht nuk kam besim tek institucioni, 3 deri diku kam besim tek institucioni, 4 kam plotësisht besim tek institucioni (një përgjigje; baza: e gjithë popullata e synuar)



Në grafikët e mëposhtëm jepet mesatarja matematikore nga dy kolonat e fundit të Tabelës 1, duke treguar prirjen në tërësi drejt nivelit të përgjithshëm të besimit dhe mosbesimit tek institucionet shtetërore si një e tërë.


PERCEPTIMI PËR POLICINË

Shumica e njerëzve në Shqipëri kanë perceptim të mirë për policinë

Pothuajse gjysma e të intervistuarve (47%) deklaruan se ata i besojnë më së shumti policisë, ndërsa 14% e të intervistuarve i besojnë plotësisht policisë. Nga ana tjetër, një e katërta (23%) e të anketuarve kanë theksuar se ata kryesisht nuk i besojnë policisë, ndërsa 16% kanë thënë se nuk e besojnë atë aspak. Besimi tek policia mbizotëron me 61%, përkundër 39% që nuk i besojnë këtij institucioni. Ky tregues në fakt është në rritje në krahasim me vitin 2016 kur ky raport ishte 56% dhe 43% përkatësisht.

GRAFIKU 2: BESIMI NË PËRGJITHËSI TEK POLICIA NË SHQIPËRI


Pyetja: Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme në Shqipëri; policia? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim tek institucioni, 2 kryesisht nuk kam besim tek institucioni, 3 deri diku kam besim tek institucioni, 4 kam plotësisht besim tek institucioni (një përgjigje; baza: e gjithë popullata e synuar)



Për sa i përket përgjigjeve sipas ndarjes gjinore, femrat evidentojnë një nivel më të lartë besimi tek policia (63%) në krahasim me meshkujt (59%). Këtu kemi të bëjmë me një ndryshim nga viti i kaluar kur të dy gjinitë deklaruan nivele të barabarta të mbështetjes për policinë. Të anketuarit nga zonat urbane (55%) shprehin më pak besim tek policia kur krahasohen me të anketuarit nga zonat rurale (67%), rezultat që është i kundërt me atë të raportuar në vitin e kaluar. Njerëzit e grupmoshës 45-59 dhe 60+ kanë të njëjtin nivel shumë të lartë të besimit tek polici, me shifra që arrijnë 65% e atyre që në përgjithësi kanë besim te policia; edhe kjo shifër ishte një ndryshim me përmbysje i rezultateve të gjetura në vitin 2016, ku ishte pikërisht grupmosha 18-29 vjeç që shprehte besimin më të madh tek policia. Të anketuarit me nivel më të ulët arsimor (deri me shkollë të mesme) i besojnë policisë më shumë në krahasim me popullsinë e përgjithshme.

GRAFIKU 3: MENDIMI I PARË PËR POLICEN FEMËR (SHUMË PËRGJIGJE)


Pyetja: Kur mendoni për policen femër, e cila është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policen mesatare femër në Shqipëri. (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Perceptimet më të zakonshme të qytetarëve shqiptarë kur bie fjala për femrat në radhët e policisë janë mirësia, kultura dhe mirësjellja. Këto janë atributet që u renditën të parat nga 25% e popullsisë së anketuar. Përveç kësaj, 17% e qytetarëve i perceptojnë femrat në polici si korrekte në kryerjen e detyrave të tyre, ndërsa 16% e të anketuarve kanë vendosur tiparet si “miqësore, e dobishme dhe komunikuese” si mendimin e parë që u vjen ndër mend për një oficere policie. Duket se për shumicën e individëve të intervistuar, rolet e paracaktuara gjinore ndikojnë në perceptimet për punonjëset femra të policisë, duke qenë se 41% e të intervistuarve i përshkruajnë ato me terma të përgjithshme, të cilat më së shumti i përshtaten perceptimit të shoqërisë për femrat sesa profesionit policor. Këto rezultate duket se janë të ngjashme me ato të vitit të kaluar.

GRAFIKU 4: MENDIMI I PARË PËR POLICEN FEMËR (PËRGJIGJET E PARA)

Pyetja: Kur mendoni për policen femër, e cila është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policen mesatare femër në Shqipëri. (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Kur krahasojmë përgjigjen e parë të dhënë në lidhje me perceptimin e punonjësve të policisë, perceptimet më të zakonshme (35%) bien në kategoritë e karakteristikave “ të mirë, të kulturuar, me mirësjellje, të këndshëm, interesantë”. Përgjigja e dytë më e përzgjedhur është |korrektësia dhe performanca e mirë” me 10%.

GRAFIKU 5: MENDIMI I PARË PËR POLICIN TIPIK (SHUMË PËRGJIGJE)


Pyetja: Kur mendoni për policin mesatar mashkull, i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policin tipik në Shqipëri (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Në dallim nga perceptimet për “policet femra të policisë”, perceptimet për “oficerin tipik mashkull të policisë” bien në ato kategori, të cilat janë më të lidhura me kërkesat për llojin e shërbimit që pritet të kryejnë oficerët e policisë në përgjithësi. Rrjedhimisht, 17% e shohin oficerin mesatar të policisë si të aftë dhe efikas, 13% të fortë, të fuqishëm dhe të përgatitur fizikisht, dhe 9% si serioz, të përgjegjshëm dhe me ndërgjegje. Ndoshta diferencimi midis oficerës femër të policisë dhe oficerit mashkull të policisë ka më shumë mundësi të jetë nënprodukt i kulturës shqiptare, mentalitetit, dhe roleve e pritshmërive gjinore të ndërtruara nga vetë shoqëria.

GRAFIKU 6: MENDIMI I PARË PËR POLICIN TIPIK (PËRGJIGJET E PARA)

Pyetja: Kur mendoni për policin mesatar mashkull, i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa karakteristika, të cilat sipas mendimit tuaj do ta përshkruanin më së miri policin tipik në Shqipëri (Baza: E gjitha popullata e synuar).




Punësimi në polici perceptohet nëpërmjet konkursit publik

Procedura e rekrutimit është një tjetër aspekt që ndikon në besimin e publikut tek policia dhe profesionalizmi e saj. Në fakt, shumica e shqiptarëve (66%) deklarojnë se forcat e policisë rekrutohen përmes një konkursi publik. Kjo shifër numër është 11% më e lartë nga viti i kaluar ku vetëm 55% ishin të sigurt për një praktikë të tillë të drejtë në procesin e rekrutimit. Sidoqoftë, edhe nepotizmi duket se luan një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e punonjësve të policisë. Pak më shumë se një e treta e të intervistuarve (36%) besojnë se punësimi në polici fitohet duke përdorur lidhjet miqësore dhe familjare, ndërsa një përqindje disi më e vogël e njerëzve (35%) mendojnë se lidhjet politike janë më të rëndësishmet kur bëhet fjalë marrjen e një vendi pune në polici në Shqipëri Rreth një e dhjeta e të anketuarve (12%) besojnë se për të fituar një vend pune në forcat e policisë përdoret rryshfeti.

GRAFIKU 7: FORMAT E PUNËSIMIT NË POLICI

Pyetja: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mënyre bëhet përzgjedhja e kandidateve për punësim në radhët e policisë? (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Në përgjithësi, krahasuar me vitin 2016, ka një trend pozitiv që tregon një rritje të besimit tek procesi i drejtë dhe profesionalizmi nëpërmjet të cilit punësohen punonjësit e policisë. Në fakt, ky konstatim mbështet gjetjet e përgjithshme të rritjes së besimit tek policia si një e tërë nga viti 2016 deri në vitin 2017.


Shumica e qytetarëve thonë se policia punon në interes të qytetarëve

Dy të tretat e të anketuarve (66%) besojnë se policia është vërtet në shërbim të qytetarëve shqiptarë. Kjo shifër është 11% më e lartë se një vit më parë. Numri i të anketuarve që mendojnë se policia punon më së shumti si një mjet për të mbrojtur interesat e partive politike është ulur me 8% krahasuar me vitin 2016 dhe tani është në nivelin e 19%. Vetëm rreth një e dhjeta (9%) e qytetarëve besojnë se policia mbron interesat e qeverisë, ndërsa një përqindje fare e vogël (5%) mendojnë se policia shërben për të mbrojtur interesat e drejtuesve të saj.

Përgjigjet e të anketuarve nuk ishin aq përcaktuese kur atyre iu bë pyetja e kundërt në lidhje me kapacitetin në të cilin vepron më së paku policia. Edhe pse ndarja e përgjigjeve ishte pothuajse në mënyrë të barabartë, 21% e të intervistuarve besojnë se cilësia në të cilin policia vepron më së paku është si “shërbim ndaj qytetarëve,” duke treguar edhe një herë një besim më të lartë në profesionalizmin e policisë.

GRAFIKU 8: SI VEPRON POLICIA

Pyetja: Në cilën cilës vepron më së shumti dhe më së paku policia në vendin tuaj? (Baza: E gjitha popullata e synuar).




Politika ndikon në punën operative të policisë

Qytetarët ende janë të mendimit se politikanët kanë një ndikim shumë të madh në punën e policisë. Shumica dërrmuese (69%) besojnë se politikanët ndikojnë plotësisht ose në një farë mase në punën operative të policisë, ndërsa 25% mendojnë të kundërtën. Megjithëse perceptimi i politizimit të policisë është ulur me 10% krahasuar me vitin e kaluar, niveli i këtij politizimi vazhdon të mbetet ende shumë i lartë. Një opinion i tillë sugjeron që qytetarët nuk e shohin policinë si një institucion plotësisht të pavarur dhe të depolitizuar. Prandaj, qytetarët shqiptarë perceptojnë se ekziston një lidhje e fortë mes punës së policisë dhe qeverisë në pushtet.

GRAFIKU 9: NDIKIMI I POLITIKËS NË PUNËN E POLICISË

Pyetja: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase politikanët kanë ndikim në punën operative të Policisë? (Baza: E gjitha popullata e synuar).



PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN

Gjykatat mbeten institucioni më i korruptuar

Sa i përket perceptimit të përhapjes së korrupsionit në dymbëdhjetë institucionet e përzgjedhura për këtë sondazh, vetëm 4 institucione kanë një rezultat “pozitiv” të shumicës së njerëzve që perceptojnë korrupsionin si jo të përhapur: bashkitë (49%), arsimiti (48%), media (45%) dhe OJQ-të (37%). Mediat dhe OJQ-të vazhdojnë të mbeten dy institucionet më pak të korruptuara me pothuajse asnjë ndryshim në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, perceptimi i korrupsionit në këto institucione është ende i lartë.

Nga ana tjetër, institucionet më të korruptuara vazhdojnë të jenë gjykatat (70%), Parlamenti (68%), prokuroria (67%), doganat (66%) dhe shëndetësia (61%). Gjithsesi, ka pasur një rënie të konsiderueshme në perceptimin e korrupsionit të këtyre institucioneve që nga viti i kaluar. Në fakt, me përjashtim të medias ku korrupsioni duket se është rritur me 1%, gjë që është statistikisht e parëndësishme, në çdo institucion tjetër duket se niveli i korrupsionit ka pësuar rënie. Ajo që mund të ketë ndikuar në këtë rezultat ndofta është reforma e diskutuar gjerësisht në sistemin e drejtësisë dhe synimi i qeverisë për t’u fokusuar në luftën kundër korrupsionit në këto institucione.

TABELA 2: KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET SHQIPTARE


Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur. (Baza: E gjitha popullata e synuar).

	VITI	NUK ËSHTË ASPAK I PËRHAPUR	PAKSA I PËRHAPUR	DISI I PËRHAPUR	SHUMË I PËRHAPUR	NUK E DI	SHUMA - (1+2) JO I PËRHAPUR	SHUMA (3+4) I PËRHAPUR
GJYKATAT	2017	4	23	35	35	3	27	70
	2016	4	13	27	52	4	17	79
KUVENDI	2017	4	25	38	30	3	29	68
	2016	5	17	25	50	3	22	75
PROKURORIA	2017	4	26	38	29	3	30	67
	2016	5	15	30	46	4	20	76
DOGANAT	2017	4	28	39	27	2	32	66
	2016	5	19	34	37	5	24	71
SHËNDETËSIA	2017	6	30	37	24	3	36	61
	2016	5	21	36	36	1	27	73
INSPEKTORËT E TREGUT	2017	5	34	37	20	4	39	57
	2016	7	25	38	23	7	32	62

POLICIA	2017	6	39	36	16	3	45	52
	2016	7	28	40	23	3	35	62
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	2017	8	37	34	16	5	45	50
	2016	13	27	31	21	9	40	51
BASHKITË	2017	6	42	34	15	3	48	49
	2016	8	32	35	20	5	40	55
ARSIMI	2017	8	41	33	15	3	49	48
	2016	11	35	34	18	2	46	52
MEDIA	2017	14	38	32	13	3	52	45
	2016	14	40	30	14	2	54	44
OJQ-TË	2017	17	40	25	12	6	57	37
	2016	18	35	25	13	8	54	38

GRAFIKU 10: PËRHAPJA E KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET SHQIPTARE

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur. (Baza: E gjitha popullata e synuar).




Perceptimi i korrupsionit në polici ka pësuar rënie

Të dhënat tregojnë se qytetarët janë të ndarë kur bëhet fjalë për perceptimin e korrupsionit në polici. Në përgjithësi, 52% besojnë se korrupsioni në polici është e përhapur, ndërsa 45% besojnë të kundërtën. Rezultatet e këtij viti janë optimiste po të krahasohen me perceptimin e vitit të kaluar për korrupsioni, shifër që një vit më parë ishte në nivelin 62% për korrupsion në polici. Vetëm 6% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni në polici nuk ekziston fare. Duket se ka një rritje të madhe prej 11% në numrin e qytetarëve që besojnë se korrupsioni në polici ekziston ende, por është “paksa i përhapur”.

GRAFIKU 11: PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN NË POLICI NË 2016 DHE 2017


Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur. (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Njerëzit që jetojnë në zonat urbane deklarojnë se ka më pak korrupsion në polici sesa ata që jetojnë në zonat rurale. Rreth 56% e të anketuarve që morën pjesë në këtë sondazh dhe që banojnë në zonat rurale mendojnë se korrupsioni në polici është në përgjithësi i përhapur. Në zonat urbane njerëzit janë të ndarë në mënyrë më të barabartë me 48% që besojnë se korrupsioni është i përhapur dhe një tjetër grup prej 48% që thonë se korrupsion nuk është i përhapur. Rezultate të ngjashme u panë edhe në vitin e kaluar ku 44% e të anketuarve në zonat urbane besojnë se korrupsioni në polici nuk ishte i përhapur.

GRAFIKU 12: PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN NË POLICI SIPAS GJINISË, MOSHËS DHE PREJARDHJES GJEOGRAFIKE

Sa i përhapur është korrupsioni në institucionet e mëposhtme? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Më shumë se gjysma e të intervistuarve meshkuj (55%) e konsiderojnë korrupsionin tek forcat e policisë si të përhapur, ndërkohë që edhe 50% e të anketuarve femra besojnë një gjë të tillë. Në vitin 2016, 59% e meshkujve të intervistuar mendonin se korrupsioni në polici nuk është i përhapur, krahasuar me 41% të femrave që mendonin kështu. Duke pasur parasysh të gjithë popullatën e intervistuar, të gjitha grupmoshat 18-59 vjeç mendojnë se korrupsioni është i përhapur në polici. Grupmosha më e re, 18-29 vjeç, është edhe grupi më pesimist për sa i përket korrupsionit në polici, ku 59% besojnë se korrupsioni në këtë institucion është i përhapur. Përkundër kësaj grupmoshe, grupmosha më e vjetër, ata 60+ vjeç, besojnë se korrupsioni nuk është i përhapur në polici (59% thonë se nuk është i përhapur). Mesatarisht, perceptimi për korrupsionin në radhët e policisë mbetet në nivele të ngjashme sipas ndarjes gjinore, grupmoshave e ndryshme dhe prejardhjes gjeografike. Afro 56% e të anketuarve të intervistuar në zonat urbane mendojnë se korrupsioni në polici nuk është aspak i përhapur. Në fakt, nuk ka dallim të madh kur të intervistuarit nga zonat urbane pyeten për përhapjen e korrupsionit, pasi 51% e tyre besojnë se fenomeni është shumë i përhapur.

Bashkëpunëtorët më të afërt të Ministrit të Brendshëm janë pjesa më e korruptuar e policisë

Brenda radhëve të policisë, vetëm bashkëpunëtorët më të afërt të ministrit kanë dalë me rezultat “negativ”, që tregon se korrupsioni është shumë i përhapur (52%). Për të gjitha njësitë e tjera të policisë, të anketuarit besojnë se korrupsioni në përgjithësi “nuk është i përhapur.” Për më tepër, vetëm oficerët e policisë së rendit publik duket se kanë bërë hapa prapa në lidhje me korrupsionin në krahasim me vitin e kaluar. Të gjitha njësitë e tjera të policisë duket se e kanë përmirësuar perceptimin e tyre publik, perceptim që thotë se tek këto njësi ka më pak korrupsion. Ndryshimi më i dukshëm nga viti 2016 deri në vitin 2017 është ai që lidhet me policinë rrugore, që ra nga 63% në 47% e të anketuarve me perceptimin se korrupsioni ishte i përhapur në këtë njësi; gjë që tregon prirjen më pozitive krahasuar me të gjitha njësitë e tjera të policisë që nga viti 2016. Një përmirësim i tillë mund të jetë ndikuar edhe nga kodi i ri i sjelljes që i është imponuar policisë rrugore si dhe nga zbatimi i disa mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, të tilla si kamera të trupit dhe kontrollet më të rregulluara të trafikut rrugor.


TABELA 3: KORRUPSIONI NË NJËSITË E POLICISË NË SHQIPËRI

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në njësitë e mëposhtme të policisë? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur. (Baza: E gjitha popullata e synuar).

	VITI	ASPAK I PËRHAPUR	PAKSA I PËRHAPUR	DISI I PËRHAPUR	SHUMË I PËRHAPUR	NUK E DI	SHUMATORE – (1+2) JO I PËRHAPUR	SHUMATORE – (3+4)
Bashkëpunëtorët më të afërt të Ministrit të Brendshëm	2017	6	35	35	17	7	41	52
	2016	8	24	25	32	11	32	57
Policia kufitare	2017	6	38	37	12	7	44	49
	2016	11	29	28	24	8	40	52

Policia rrugore	2017	6	42	35	12	5	48	47
	2016	7	26	36	27	4	33	63
Policia kriminale	2017	9	38	34	12	7	47	46
	2016	14	28	25	33	10	32	58
Policia e rendit publik dhe sigurisë	2017	9	40	37	7	7	49	44
	2016	19	34	27	15	5	53	42
Administrata (nxjerrja e dokumenteve personale)	2017	11	42	34	8	5	53	42
	2016	19	30	25	22	4	49	47
Forcat speciale të policisë	2017	22	36	25	8	9	58	33
		25	25	23	18	9	50	41


GRAFIKU 13: PERCEPTIMI I PËRGJITHSHËM PËR KORRUPSIONIN NË POLICI



Si mesatare, korrupsioni në radhët dhe njësitë e policisë duket se është në rënie që nga viti i kaluar. Në fakt, 45% e të anketuarve bien dakord se korrupsioni nuk është i përhapur, krahasuar me shifrën e vitit 2016, që ishte 51%.

GRAFIKU 14: PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN NË NJËSI TË CAKTUARA TË POLICISË

Pyetja: Sa i përhapur është korrupsioni në njësitë e mëposhtme të policisë? Ju lutemi përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 - nuk është aspak i përhapur, 2 – paksa i përhapur, 3 - disi i përhapur dhe 4 – shumë i përhapur. (Baza: E gjitha popullata e synuar).



LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT


Më shumë qytetarë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin e policisë nëse të dhënat e denoncuesit do të ishin konfidenciale

Në vitet e fundit në Shqipëri rolit të publikut për denoncimin e rasteve të korrupsionit të policisë i është vënë një theks i veçantë. Kështu, më shumë se gjysma e shqiptarëve (54%) ishin të gatshëm të denonconin rastet e korrupsionit të policisë. Kjo shifër përbën një përmirësim në krahasim me vitin e kaluar kur vetëm 47% ishin të gatshëm të denonconin nëse do t'u kërkohej të bënin të ditura të dhënat e tyre personale. Nga ana tjetër, 38% nuk ishin të gatshëm të raportonin raste korrupsionit të policisë nëse zbulohet identiteti i tyre. Megjithatë, duket se zbulimi i të dhënave personale mund të jetë një farë pengese për denoncimin e rasteve të korrupsionit në polici. Më pas u vazhdua me pyetjen për të intervistuarit që u shprehën se nuk ishin të gatshëm të denonconin një rast korrupsioni të policisë duke dhënë bërë të ditur të dhënat e tyre personale. Ata u pyetën nëse ata do të ishin të gatshëm të raportonin raste korrupsioni në radhët e policisë nëse identiteti i tyre do të mbahej i fshehtë. Nga ky grup të intervistuarish, 53% mbetën të pandryshueshëm në përgjigjen e tyre të mëparshme, ndërkohë që 29% ndryshuan mendim, duke u shprehur se do të raportonin një rast korrupsioni në radhët e policisë, ndërsa një pjesë tjetër, 18%, refuzuan të përgjigjen. Kjo tregon se rreth një e treta e popullsisë mund të jenë të gatshëm të denoncojnë raste korrupsioni në radhët e policisë, nëse mekanizmat për raportimin e këtyre rasteve do të ishin më fleksibël për të bërë të mundur ruajtjen e fshehtësisë së denoncuesve të rasteve të korrupsionit.

Gjithsesi, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje të gatishmërisë së qytetarëve për të denoncuar korrupsionin e policisë.

GRAFIKU 15: DENONCIMI I KORRUPSIONIT TË POLICISË NË SHQIPËRI


Pyetja 1: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)? (Baza: E gjitha popullata e synuar); Pyetja 2: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse nuk do t'ju duhej që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)? (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Edhe pse në të gjithë popullatën e intervistuar, shqiptarët janë më shumë të predispozuar për të denoncuar korrupsionin në radhët e policisë, ekzistojnë disa dallime të vogla për sa i përket ndarjes gjinore, prejardhjes dhe grupmoshës. Të intervistuarit nga zonat rurale kanë më shumë gjasa të denoncojnë raste korrupsioni të policisë (55%) në krahasim me ata që vijnë nga zonat urbane (52%). Ky rezultat është e kundërta e vitit të kaluar, ku njerëzit në zonat urbane ishin më të gatshëm të raportonin korrupsionin e policisë (edhe pse me një ndryshim të vogël prej 1%). Një ndryshim tjetër i rëndësishëm ka ndodhur në denoncimin mes femrave dhe meshkujve. Në vitin 2016, të intervistuarat femra ishin më shumë të gatshme të denonconin korrupsionin e policisë (51%) në krahasim me 49% të meshkujve të intervistuar. Në vitin 2017, 57% e të anketuarve meshkuj ishin të gatshëm të raportonin korrupsionin në radhët e policisë, ndërsa vetëm 51% e femrave u shprehën se do të bënin një gjë të tillë. Sa i përket grupmoshave, grupmosha që ka më shumë gjasa të raportojë korrupsionin e policisë është ajo 18-29 vjeç, e ndjekur nga grupmosha 30-44 vjeç, me 59% dhe 53% përkatësisht. Edhe grupmosha e fundit duket se ka pasur ndryshimin më të madh në mendimin për raportimin e korrupsionit në radhët e policisë duke shkuar nga niveli prej 43% e të anketuarve të gatshëm për të denoncuar në 2016 në 53% në vitin 2017.

GRAFIKU 16: MOSHA, GJINIA DHE PREJARDHJA NË DENONCIMIN E KORRUPSIONIT NË RADHËT E POLICISË

Pyetja: A do ta denonconit një rast korrupsioni në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të jepni të dhënat tuaja personale (numrin personal, adresën, etj.)? (Baza: E gjitha popullata e synuar).



Rajonet e policisë dhe media mbeten zgjedhja e parë për denoncimin e korrupsionit në polici


Ndër institucionet tek të cilat qytetarët do të raportonin së pari një rast të mundshëm korrupsioni në radhët e policisë janë rajonet e policisë (56%) dhe mediat (48%). Edhe pse këto dy njësi ishin zgjedhjet e para edhe në vitin 2016 (të dyja me 58%), duket se ka një rënie në besimin e qytetarëve për të raportuar korrupsionin më radhët e policisë tek këto institucione, veçanërisht tek media.

Ka një tendencë në rritje që tregon se qytetarët janë më të gatshëm të raportojnë korrupsionin e policisë tek institucionet. Për shembull, 8% më shumë e të intervistuarve janë të gatshëm të raportojnë tek shefi i policisë, 15% më shumë do të raportonin një rast korrupsionit të policisë tek organet e anti-korrupsionit dhe 7% më shumë tek shërbimi i kontrollit të brendshëm të policisë. Ndërkohë, njerëzit janë më pak të predispozuar të raportojnë raste të tilla tek mekanizmat joformalë, siç janë 'një shoku/shoqeje që punon në polici'.

Institucionet më pak të besuara për raportimin e korrupsionit të policisë janë OJQ-të, ku vetëm 11% e të intervistuarve ishin të gatshëm t'u drejtoheshin atyre. Edhe pse është rritur që nga viti i kaluar, kjo shifër është ende e ulët, gjë që tregon se shumica e qytetarëve mund të mos jenë të ndërgjegjshëm për rolin e OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit

GRAFIKU 17: ZGJEDHJA E PARË PËR DENONCIMIN E KORRUPSIONIT NË RADHËT E POLICISË (SHUMË PËRGJIGJE)


Pyetja: Cilit nga lista e mëposhtme do t'i raportoni të parit rastin e korrupsionit në polici? (Baza: ata që janë të gatshëm të denoncojnë raste korrupsioni në radhët e policisë).



Po ashtu, edhe kur të anketuarit u pyetën të zgjedhin vetëm një institucion tek i cili do të denonconin rastet e korrupsionit, rezultatet në përgjithësi përkrijnë me ato të mëparshmet (shih Tabelën 17).

GRAFIKU 18: ZGJEDHJA E PARË PËR DENONCIMIN E KORRUPSIONIT NË RADHËT E POLICISË (PËRGJIGJET E PARA)

Pyetja: Cilit nga lista e mëposhtme do t'i raportoni të parit rastin e korrupsionit në polici? (Baza: ata që janë të gatshëm të denoncojnë raste korrupsioni në radhët e policisë).




Ndëshkimi si mënyra më efektive për parandalimin e korrupsionit në polici

Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se ndëshkimet e ashpra për shkelësit dhe drejtuesit e policisë janë çelësi për parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë. Krahasuar me vitin e kaluar, ku 23% e njerëzve mbështesnin dënimin e drejtpërdrejtë për keqbërësit, në vitin 2017, më shumë qytetarë (26%) e konsiderojnë këtë si mekanizmin kryesor për të luftuar korrupsionin në polici. Nga ana tjetër, më pak njerëz besojnë se drejtuesit dhe punonjësit e policisë duhet të vuajnë pasojat e korrupsionit në radhët e policisë. Në 2016, 22% e të intervistuarve besonin se ndëshkimi i rreptë për policët ishte zgjidhja më e mirë, ndërsa në vitin 2017 kjo përqindje ra në 18%.

Mekanizma të tjerë të preferuar janë rritja e pagave të oficerëve të policisë, me 13% që mbështetnin këtë ide, dhe krijimin e një organi të ri që do të parandalonte korrupsionin në radhët e policisë, me 11% të të intervistuarve. Mekanizmi më pak i mbështetur ishte motivimi i qytetarëve për të denoncuar zyrtarët e korruptuar të policisë, ku 6% e qytetarëve e zgjedhën këtë si alternativën më të mirë.

GRAFIKU 19: ÇFARË NEVOJITET PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË POLICI?

Pyetja: Sipas mendimit, çfarë është më e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë? (Baza: E gjitha popullata e synuar).




Qeveria duhet të udhëheqë luftën kundër korrupsionit

Ashtu si edhe në vitin 2016, shumica e shqiptarëve (31%) besojnë se qeveria duhet të udhëheqë luftën kundër korrupsionit në radhët e policisë, pasuar nga Ministri i Brendshëm (16%), Agjencia Antikorruption (11%) dhe Drejtori i Policisë (10%). Shumë institucione të rëndësishme vazhdojnë të marrin një rezultat të ulët në luftën kundër korrupsionit në policisë, me OJQ-të në nivelin 1%, Parlamenti në 2% (një rënie prej 3% nga viti i kaluar) dhe vetë oficerët e policisë në 5%.

Nuk ka dallime të mëdha për nga mosha, gjinia apo vendbanimi në lidhje me këto kategori. Pjesa më e madhe e grupmoshave, si meshkujt ashtu edhe femrat, qoftë njerëz në zonat rurale apo në ato urbane zgjedhën Qeverinë si institucionin kryesor për të luftuar korrupsionin. Çuditërisht, komuniteti ndërkombëtar është rritur nga 2% në 8%, duke u bërë kështu një organ tjetër i rëndësishëm për luftën kundër korrupsionit në radhët e policisë, ndërsa Prokuroria ka humbur besimin e shqiptarëve duke qenë se vetëm 6% besojnë se ajo duhet të jetë e para për të luftuar korrupsionin në polici, në krahasim me 12% që ishte në vitin e kaluar.

GRAFIKU 20: ROLI I INSTITUCIONEVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Pyetja: Shikoni listën e mëposhtme të institucioneve dhe thoni se cili nga institucionet para të gjitha të tjerave duhet të luftojë korrupsionin në polici. (Baza: E gjitha popullata e synuar).




Shoqëria civile duhet të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit

Edhe pse shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit përmes rritjes së ndërgjegjësimit, monitorimit dhe ndihmës në ngritjen e kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, mbi një e treta (35%) e shqiptarëve besojnë se OJQ-të duhet të marrin pjesë aktive në luftën kundër korrupsionit dhe 20% preferojnë që ato të bashkëpunojnë me shtetin. Plot 18% e të intervistuarve besojnë se OJQ-të duhet të luajnë një rol këshillues dhe të ofrojnë rekomandime për luftën kundër korrupsionit, 13% mendojnë se OJQ-të duhet të ofrojnë ndihmë për viktimat e korrupsionit dhe 11% shprehen se OJQ-të duhet të promovojnë vlerat etike brenda institucioneve.

Kur këto rezultate krahasohen me ato të vitit 2016, këtë vit shqiptarët po i vënë më shumë theksin një roli më të madh “këshillues” dhe rritjes së kapaciteteve për OJQ-të sesa këto të fundit të marrin pjesë aktivisht në luftën kundër korrupsionit. Krahasuar me vitin e kaluar (43%), në vitin 2017, vetëm 36% besojnë se OJQ-të duhet të luajnë një rol aktiv dhe 20%, në krahasim me 26% të vitit të kaluar, besojnë se ato duhet të bashkëpunojnë me shtetin.

GRAFIKU 21: ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Pyetja: Njerëzit kanë mendime të ndryshme për rolin e organizatave joqeveritare në luftën kundër korrupsionit. Duke marrë këtë parasysh, cili mendoni se do ishte roli që duhet të luajnë OJQ-të në luftën kundër korrupsionit? (Baza: E gjitha popullata e synuar).



KUADRI METODOLOGJIK

Vendi	Shqipëri
Koha	Korrik 2017
Metoda e mbledhjes së të dhënave	Intervista ballë për ballë, në vendbanimet e të intervistuarve
Kampionimi	Qytetarë dhe qytetare të Shqipërisë të moshës mbi 18 vjeç, të cilët janë me banim të përhershëm në territorin e Shqipërisë në kohën e kryerjes së këtij sondazhi.
Madhësia e kampionit	1,000
Lloji i kampionit	Kampion me shtresëzim përfaqësimi rastësor me tre faza
Shtresëzimi	Kryer sipas rajoneve, llojit të vendbanimit, gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit
Marzhi i gabimit	±3.31%

POINTPULSE

WESTERNBALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST

WWW.POINTPULSE.NET



twitter.com/POINTPULSEnet



facebook.com/POINTPULSEnet/

Civil society network dedicated to
oversight of police integrity.